



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr.60/01-31713/20
Kaçanik, 29.12.2020

PROCESVERBAL

Nga mbledhja **X-të (dhjetë)** e Rregullt e Komitetit për Komunitete për vitin 2020, mbajtur me datë 29 Dhjetor 2020 (e Martë). Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës Komunale, në sallën e Komiteteve të Kuvendit të Komunës, me fillim pune në ora 11:00.

Pjesëmarrës të këtij takimi nga Komiteti për Komunitete ishin 7 anëtarët: Lirije Luta-PDK, Kaltrina Tafili- LVV, Nazife Krasniqi-LDK, Hajredin Luta-AAK, Shemsedin Abazi - KMLDNJ, Elmihane Krasniqi-Malsiu-HANDIKOS dhe Naim Hysa- Kryqi i Kuq.

Mbledhjen e kryesoi Lirije Luta, Kryesuese e Komitetit për Komunitete.

Procesmbajtës: Arbnora Kuka, Asistente e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

Kryesuese e Komitetit, znj.Lirije Luta, Fillimisht përshëndes të pranishmit, konstatoj kuorumin dhe hapi mbledhjen e X-të (dhjetë) të rregullt të Komitetit për Komunitete për vitin 2020, data 29 Dhjetor, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete e vitit 2020;
2. Strategjia për përmbushjen e Planit të Punës së Komitetit për Komunitete;
3. Hartimi i Planit të Punës së Komitetit për Komunitete; dhe
4. Të ndryshme.

Nëse ka diçka rreth rendit të punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendi i punës u shtrua në votim dhe u votua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se Komiteti për Komunitete e,

APROVOJ

Rendin e punës, në përbërje prej 4 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas radhës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete;

Procesverbali i mbledhjes së IX (nëntë) të rregullt të Komitetit për Komunitete i vitit 2020, doli në votim dhe u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se Komitetit për Komunitete e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së IX (nëntë) të Komitetit për Komunitete të vitit 2020, të datës 07.12.2020/Lënda 01Nr.60/01-29889/20.

2. Strategjia për përmbushjen e Planit të Punës së Komitetit për Komunitete

Kryesuese e Komitetit ,znj. Lirije Luta, A keni diçka lidhur me këtë pikë?Dje kemi zhvilluar aktivitetin , kemi qenë në komunën e Hanit të Elezit.Qëllimi i takimit ka qenë për hartimin e planit të punës së komitetit për komunitete, për të parë planin e tyre të punës dhe shkëmbimin e ideve. Mirëpo edhe ato e kanë parë se plani ynë i punës është shumë më korrekt se plani i tyre. Ato e trajtonin planin e punës së Kuvendit të komunës së Hanit të Elezit.Ato shprehën kënaqësi për takimin që ishim. Nëse keni dikush për diskutim, urdhëroni.

Znj.ElmiHane Krasniqi-Malsiu, Unë mund ta quaj të përbushur këtë plan, ka qenë i suksesshëm duke marrë parasysh kohën e pandemisë covid-19. I kemi përbushur të gjitha pikat e planit të punës që i kemi paraqitur. Sa i përket komunës së Hanit të Elezit që ishim në vizitë, jemi shumë më mirë se komuna e Hanit të Elezit me planin e punës.Ato i trajtonin planin e Kuvendit të Komunës, jo kërkesat e qytetarëve që si komitet për komunitete duhet ti trajtojnë.

Kryesuese e Komitetit ,znj. Lirije Luta, Ne kemi pasur plan të organizojmë takime edhe me komuna tjera , por për shkak të pandemisë covid-19, nuk kemi mbajtur takime.Kam kontaktuar me komunën e Ferizajt por nuk shprehën gatishmëri për takim. I kam kontaktuar edhe komunat e Vitisë dhe Gjilanit.Komuna e Ferizajt e kanë përafërsisht planin e njejt si ne, përveq se ato kanë edhe minoritete dhe kanë edhe tema shtesë.

Znj.ElmiHane Krasniqi-Malsiu, Edhe ju anëtarët e komitetit që jeni nga subjektet politike, jeni për çdo lëvdatë , sepse asnjëherë nuk keni reaguar pse jeni prej subjekteve të ndryshme.Unë Shemsedini dhe Naimi jemi prej shoqërisë civile dhe çdo çështje që kemi ngritur ne, ju vetëm na keni përkrah.

Kryesuese e Komitetit ,znj. Lirije Luta, Faleminderit ElmiHane. Edhe unë jam e kënaqur pikërisht për këtë çështje, sepse që në fillim ne kemi thënë që nëse është çështja në interes të qytetarëve nuk ka parti, PDK, LDK,AAK dhe VV.

Znj.Nazife Krasniqi, Ne e pamë se për realizimin e këtij plani të punës, ishim më para komunës së Hanit të Elezit.Ne e kemi ditur se do ta mernin planin tonë , por e kishin planin e Kuvendit të komunës së Hanit të Elezit. Ato na përkrahën dhe na dhanë lëvdata. Edhe në këto kushte të pandemisë e kemi përbushur planin e punës me sukses.

3.Hartimi i Planit të Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2021

Kryesuese e Komitetit ,znj. Lirije Luta, ne kemi biseduar lidhur me planin e punës . Kam kërkuar nga ju të keni nga një pikë.Nazifja i ka dërgu disa edhe ju keni dhënë disa ide.

Znj.ElmiHane Krasniqi-Malsiu, Jam munduar të përshkruaj planin e punës së vitit të kaluar. I kam shtuar edhe disa por mund të bëjmë ndryshime.znj.ElmiHane e lexoi të gjithë planin e punës së komitetit për komunitete për vitin 2021.

Kryesuese e Komitetit ,znj. Lirije Luta, Me disa pika pajtohem siç janë pikat 1,2,3,4 edhe ndarjen e granteve. Të drejtat t qytetarëve në komunën e Kaçanikut ,mendoj që ta kemi një tem tjetër, unë jam në dilem për këtë pikë.Te aktivitetet rinore do ta kisha përfshirë në arsim.Krijimi i hapësirave për parkingje , drejtori e ka një projekt dhe do të zgjidhet për vitin 2021.Mund ta lëmë si opcion.

Znj.ElmiHane Krasniqi-Malsiu, Qëllimi pse e kam lënë këtë pikë , ka qenë për te shkolla fillore “Emin Duraku”, që nuk ka vend për parking. Një kërkesë nga një qytetar ishte që të vendosen mbrojtëse rreth trotuareve , të mos lejohet parkingu i veturave në trotuare.Aktivitetet rinore mund të futen te drejtorja e arsimit , por dallojnë aktivitetet.Te gjendja e arsimit në Kaçanik i kam paraparë edhe aktivitetet brenda shkollave që organizohen dhe motivimi i nxënësve të suksesshëm.Do të ishte mirë që të motivohen nxënësit e suksesshëm.

Kryesuese e Komitetit ,znj. Lirije Luta, Te ndarja e granteve të shkruhet diskutim e jo monitorim. Nëse është monitorim duhet ti përcjellim kur bëhet ndarja e granteve.

z.Naim Hysa, Këtu mendoj që do të ishte më mirë që dikush nga anëtarët e komitetit të merr pjesë gjatë ndarjes së granteve, se sa të bisedojmë për to.Të përkrahet dikush që ka nevojë.

Znj.ElmiHane Krasniqi-Malsiu, Qëllimi edhe në vitin e kaluar ka qenë të monitorohen kur bëhet ndarja, ne nuk kemi marrë se ndoshta edhe nuk na kanë njoftuar.

z.Naim Hysa ,Të na ofrohet material se në bazë të cilave kritereve është bërë ndarja, dokumentacion.

Kryesuese e Komitetit ,znj. Lirije Luta, Është pak problem të monitorohen ndarja e granteve. Por nëse ju pranoni dikush të monitoroni nuk është problem. Shtojmë edhe një pikë ,Takim me drejtoritë para ndarjes së granteve, varësisht se cila drejtori bënë ndarjen. Edhe takimi me klubet sportive, ato i kan adresuar çështjet e tyre.

Znj.Nazife Krasniqi, Te pika e parë, pse të mos vizitohen QMF-t në fshatra, të shohim se si funksionojnë. Të dimë gjendjen reale a funksionojnë apo kan mbetur vetëm objekte. Kanë nevojë të kenë gjërat elementare.

Znj.Kaltrina Tafili, Jam interesuar , më herët kanë funksionuar, por gjatë pandemisë janë mbyllur.Punojnë vetëm infermieret.

Znj.Nazife Krasniqi, Te Drejtorja e Arsimit dhe Kulturës, të shtohet një pikë, të bisedojmë me këshillin e prindërve dhe këshillin e nxënësve. Kishte nxënës që është ndalur nga shkolla për shkak të pamundësisë së pagesës së transportit.Të bisedojmë me këshillat e nxënësve të shkollave të mesme dhe të njoftohemi me problemet në shkolla.

Znj.Kaltrina Tafili, Në fshatin Dubravë, në Vataj të epërm , i ndalin fëmijët nga shkolla për shkak se duhet të ecin në rrugën kryesore.

z.Naim Hysa, Edhe në fshatin Stagovë ka probleme të ndryshme, nuk ka as trotuare as ndriçim.Janë nxënësit e lagjes Dashi që udhëtojnë mbi 3 km në këmbë , por nuk i arrijnë 4 km, që ti sigurohet transporti.Te aktivitete brenda shkollave mund ti hapim këto probleme me këshillat e prindërve dhe këshillat e nxënësve.

Znj.Kaltrina Tafili, I kishim futur edhe dukuritë negative.

Znj.Nazife Krasniqi, Besoj që vijnë, se kanë pyetur prej cilës moshë kanë të drejtë të marrin pjesë në debate publike.

Kryesuese e Komitetit ,znj. Lirije Luta, Ne në muajin shkurt fillojmë me takime. Në muajin janar aprovohet plani i punës së komitetit për komunitete.

Znj.ElmiHane Krasniqi-Malsiu, Nëse nuk keni diçka tjetër i shohim edhe njëher pikat që ndryshojnë në plan të punës.

Kryesuese e Komitetit ,znj. Lirije Luta , fillojmë nga pika 1. Covid-19, të shënohet gjendja e pandemisë Covid-19- (Shkurt-Shtator). Është mirë që edhe temat që i mbajmë , të i përshtaten muajit në të cilin mbahen. Ato që janë më me prioritet të futen në fillim.

Znj.ElmiHane Krasniqi-Malsiu, Janar – Shtator është koha kur mund të realizohen aktivitetet.te pika 4, mund ta shtojmë te aktivitetet , takim me këshillat e nxënësve dhe këshillat e prindërve.te pika 5 a e heqim, unë e shoh të arsyeshme mu kanë si pikë.Te pika 7, aktivitetet rinore në Kaçanik, të shtohet edhe me këshillat e nxënësve, ato të japin ndonjë propozim.

Kryesuese e Komitetit ,znj. Lirije Luta, Të gjitha aktivitetet e komitetit i bëjmë në periudhën Shkurt-Shtator.

z.Naim Hysa, Këto janë aktivitete të KVRL-s. Aktivitetet e nxënësve në shkolla me aktivitetet e rinisë, ndoshta kanë dallim .

Znj.Nazife Krasniqi, Kjo le të jetë vetëm e arsimit, ndërsa kjo tjetra për rini në përgjithësi.

Kryesuese e Komitetit ,znj. Lirije Luta, te pika 10 – krijimi i hapësirave të parkingjeve, kisha thënë ta heqim këtë pikë.

z.Naim Hysa, Krijimi i hapësirave për parkingje, ne mund të japim propozimet, kur bëhen rrugë të reja.

Kryesuese e Komitetit ,znj. Lirije Luta, Te sporti a e shtojmë ndarjen e granteve?

Znj.ElmiHane Krasniqi-Malsiu, Janë të cekura.

Znj.Kaltrina Tafili, Plani shumë i mirë.Kam propozime por në Kuvend.Të ndihmohen nënat e reja me 100€ për lindje.Komuna e Ferizajt e ka bërë këtë.Këtë pikë do ta propozoj edhe në Kuvend.

Znj.ElmiHane Krasniqi-Malsiu, E futim si pikë në plan të punës, si aktivitet te rastet sociale.

z.Naim Hysa, Të futet te rastet sociale, si aktivitet, inicimi për përkrahje për nënat lehona dhe nënat vetushqyese.

Kryesuese e Komitetit ,znj. Lirije Luta, Nëse nuk keni diçka tjetër lidhur me këtë pikë, kalojmë në pikën tjetër të rendit të punës.

Të ndryshme

Kryesuese e Komitetit ,znj. Lirije Luta, Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, mbledhja i përfundoi punimet në ora 11:54.

Procesmbajtës
Arbnora Kuka



Kryesuese e Komitetit
Lirije Luta

